



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të neneve 12.2, pika d), 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr. 28, dt. 04.06.2008), bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës nr. I-34, dt. 25.04.2016, nenin 39 të Rregullores së Punës së Kuvendit nr. I-95, dt. 29.06.2018, neni 5 dhe 6 i Ligjit 04/L-179 për Transportin Rrugor, Rregullores nr. -I- 108, e dates 25.11.2016, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të Komunës, me nr. 02-104/02-11104/26, të datës 22.04.2026 si dhe rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 24.04.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2026, mori këtë:

V E N D I M


1. Miratohet subvencionimi për kilometër në nisje i 10 linjave të transportit publik në Komunën e Obiliqit:
 - Obiliq – Prishtinë
 - Breznicë – Babimoc – Obiliq – Prishtinë
 - Kozaricë - Breznicë – Babimoc – Obiliq – Prishtinë
 - Graboc – Siboc – Obiliq - Prishtinë
 - Hamidi – Palaj - Obiliq - Prishtinë
 - Dardhishtë – Prishtinë
 - Obiliq – Fushë Kosovë
 - Bakshi – Raskovë - Obiliq - Prishtinë
 - Hade e Re – Mazgit - Obiliq - Prishtinë
 - Hade – Mirash - Palaj
2. Subvencionimi nga pika 1 do të bëhet nga kategoria “Subvencione dhe Transfere” nga të hyrat vetanake në vlerë 0.75€ për kilometër, 27,147.31€ në muaj apo 325,767.74€ në vit.
3. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL-së, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Nënkryetarit të Komunës
- Anëtarëve të KK
- DAP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Sami Ahmeti